

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shtëpia e Bardhë shtron tapetin e kuq për Xi Jinping, përgatitje madhështore për vizitën historike
ADRESA	https://piranjat.al/bota/shtepia-e-bardhe-shtron-tapetin-e-kuq-per-xi-jinping-pergatitje-madheshtore-i105678
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:59:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 16:47:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	09c619c2ecdd2a30cb353443dc2efb070a45ab50e66bd27f218597bd3b58d72f
TEKSTI	55ced1fa29a4d0d18bdd564d3ce7de50a66daf2c07d65d6619077a5ad2685ee1
PAMJA	e1554ea68ef662bf8f261c5b04c570730184975332cc3f41aafbc278f10c051e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b56d3c34da3c77f3b5f58c7ce4e10b21507cb8e99a95c4c6bbb4bf8d38c79775
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b56d3c34da3c77f3b5f58c7ce4e10b21507cb8e99a95c4c6bbb4bf8d38c79775>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: për akuzat perqendronem te problemi yt... Të gjithë ne Do të është bosi shqiptar i shqiptar dhe i konsideruar nga SPAK strukturuar ish-drejtoreshën e S... do të bjerë si tigër prej k&e... Ja kë po përpiqet të e shprehim Informativ të Shtetit, Vlorë H...

[BOTA](#)

Shtëpia e Bardhë shtron tapetin e kuq për Xi Jinping, përgatitje madhështore për vizitën historike

Piranjat Përditësimi i fundit 23 Shtator 2026, 18:47



Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, do të presë këtë javë në Washington presidentin kinez Xi Jinping, në një vizitë shtetërore ku pritet të diskutohen një sërë çështjesh të rëndësishme, nga inteligjenca artificiale dhe tregtia, te Tajvani dhe marrëdhëniet mes dy fuqive globale.

Xi pritet të pritë personalisht nga Trump në bazën ajrore Andrews të mërkurën, 23 shtator.

Të enjten, në Shtëpinë e Bardhë do të zhvillohet ceremonia zyrtare e pritjes, e cila do të shoqërohet me një fluturim ceremonial të avionëve ushtarakë dhe pjesëmarrjen e afro 500 efektivëve të ushtrisë amerikane.

Kjo është vizita e parë shtetërore e Xi Jinping në SHBA pas gati një deкаде dhe takimi i tretë me Trump që nga rikthimi i presidentit amerikan në Shtëpinë e Bardhë për mandatin e dytë.

Vizita zhvillohet në një moment delikat për marrëdhëniet mes Washingtonit dhe Pekinit. Marrëveshja tregtare SHBA-Kinë, e arritur vitin e kaluar, pritet të skadojë në nëntor.

Marrëveshja, e arritur në tetor 2025 gjatë takimit Trump-Xi në Korenë e Jugut, parashikonte pezullimin nga Washingtoni të rritjeve të forta të tarifave ndaj mallrave kineze, ndërsa Pekini lehtësoi kufizimet mbi eksportet e tokave të rralla, të cilat janë thelbësore për sektorin e prodhimit.

Ekspertët presin që gjatë vizitës së Xi-t të ketë të paktën një njoftim lidhur me zgjatjen e kësaj marrëveshjeje.

Vizita e presidentit kinez në Washington do të zgjasë deri të premtën dhe do të shoqërohet me një program të ngjeshur ceremonial, përfshirë darka zyrtare, vizita private dhe shfaqje artistike.

David Sacks, studiues për Azinë në Council on Foreign Relations, e cilësoi pritjen e planifikuar nga Trump si diçka “vërtet të paprecedentë”.

“Që Trump ta presë Xi Jinping në bazën ajrore Andrews dhe të organizojë edhe një fluturim ceremonial për të, nuk është diçka që u ofrohet as aleatëve të SHBA-ve, aq më pak një kundërshtari si Kina”, tha Sacks, duke e cilësuar pritjen si “mjaft befasuese”.

Tregtia dhe tarifat

Një nga çështjet kryesore në takimet Trump-Xi pritet të jetë tregtia dhe tarifat.

Trump ka kritikuar prej kohësh deficitin tregtar të SHBA-ve me Kinën, i cili, sipas të dhënave më të fundit të Byrosë së Regjistrimit të SHBA-ve, tejkalon 91 miliardë dollarë.

Ndërkohë, pavarësisht marrëveshjes së titorit të kaluar, eksportet kineze të tokave të rralla drejt SHBA-ve kanë rënë.

Zyrtarët amerikanë dhe kinezë zhvilluan bisedime tregtare në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, por, sipas burimeve të BBC-së, nuk arritën ndonjë përparim të rëndësishëm përpara vizitës së Xi-t.

Bisedimet u përqendruan te çështjet tregtare jotarifore dhe eksportet bujqësore. Negociatorët amerikanë pritet të vazhdojnë bisedimet me homologët kinezë në Washington, pas mbërritjes së Xi.

Inteligjenca artificiale, një tjetër pikë kyçe

Inteligjenca artificiale pritet të jetë një tjetër temë e rëndësishme në takimin mes dy liderëve.

David Firestein, nga Bush China Foundation, tha për BBC-në se AI-ja është ngjitur me shpejtësi në krye të agjendës përpara vizitës së Xi-t.

SHBA-ja dhe Kina janë në konkurrencë të fortë për zhvillimin e inteligjencës artificiale, ndërsa teknologjia është shndërruar në një prej fushave kryesore të rivalitetit mes dy vendeve.

Pas disa incidenteve të profilit të lartë që kanë ngritur shqetësime për sigurinë e AI-së, është shtuar presioni ndaj administratës Trump për të vendosur rregulla më të forta dhe për të ngadalësuar zhvillimin e kësaj teknologjie.

Senatori Bernie Sanders shkroi këtë javë në X se Trump dhe Xi duhet të negociojnë një marrëveshje për të pezulluar zhvillimin e AI-së dhe për të ndaluar inteligjencën artificiale superinteligjente.

Edhe ish-këshilltari i Trump në Shtëpinë e Bardhë, Steve Bannon, si dhe disa republikanë në Kongres, kanë paralajmëruar për rreziqet që mund të sjellë inteligenca artificiale.

Trump, megjithatë, e konsideron AI-në thelbësore për ekonominë amerikane dhe një fushë kyçe të konkurrencës globale për fuqinë. Ai ka qenë i rezervuar ndaj idesë për të frenuar zhvillimin e saj dhe e ka cilësuar mposhtjen e Kinës në garën për AI si një objektiv kryesor.

“Kush fiton AI-në, fiton”, ka deklaruar Trump.

Firestein tha për BBC-në se pret që Trump dhe Xi të diskutojnë edhe mënyrat për bashkëpunim në fushën e inteligjencës artificiale.

Të dielën, Sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, u takua me homologun e tij kinez He Lifeng. Bessent i cilësoi bisedimet për tregtinë dhe AI-në si “shumë të suksesshme”.

Megjithatë, ekspertët që folën për BBC-në thanë se nuk presin ndonjë marrëveshje të madhe ose përparim të rëndësishëm në AI apo çështje të tjera gjatë takimeve të shumta mes Trump dhe Xi këtë javë.

Tajvani, një tjetër pikë e nxehtë

Në tryezën e diskutimeve pritet të jetë edhe Tajvani, një prej çështjeve më të ndjeshme në marrëdhëniet SHBA-Kinë.

Kongresi amerikan ka miratuar një paketë shitjesh armësh me vlerë disa miliardë dollarë për Tajvanin, e cila aktualisht pret firmën e Trump. Presidenti amerikan deri tani ka vendosur të mos e nënshkruajë, duke e parë këtë çështje edhe si një mjet negociues në raport me Kinën.

Pekini prej kohësh ka deklaruar synimin për “ribashkimin” me Tajvanin dhe nuk ka përjashtuar përdorimin e forcës.

Sipas Firestein, Xi pritet t'i kërkojë Trumpit të zgjasë shtyrjen e shitjes së armëve ose, në një formë tjetër, të shmangë realizimin e saj.

Edhe Xi përballet me vështirësi ekonomike në vendin e tij dhe pritet ta shfrytëzojë vizitën për të diskutuar mundësitë e thellimit të tregtisë mes SHBA-ve dhe Kinës.

Por një afirmim i tillë mund të krijojë probleme politike për Trumpin, pasi disa anëtarë të kabinetit të tij dhe mbështetës të tij e shohin Kinën me dyshim të madh.

Sekretari amerikan i Transportit, Sean Duffy, i dërgoi në shtator një letër kompanisë Ford, duke e nxitur atë të shkëputte lidhjet me Kinën, për shkak të shqetësimeve për sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen e vendeve të punës në SHBA.

Pavarësisht pengesave që mbeten përpara arritjes së marrëveshjeve të reja mes dy vendeve, Trump e konsideron kontaktin e drejtpërdrejtë me Xi-n një element të rëndësishëm të procesit.

“Trump ka marrë vendimin se, pavarësisht gjithçkaje, ne nuk duhet të kemi një marrëdhënie konfrontuese me Kinën”, tha Stephen Orlins, president i National Committee on US-China Relations.

Sipas Orlins, Trump beson se sa më shpesh të takohen ai dhe Xi, aq më pak konfrontuese do të jetë marrëdhënia mes dy vendeve.

Artikuj te sugjeruar

BOTA 23 Shtator18:42

[Fenomeni El Niño kërcënon me 500,000 vdekje të tjera këtë vit](#)

Gati gjysmë milioni vdekje më shumë për shkak të nxehtësisë rekord dhe një fenomeni të fuqishëm El Niño...

BOTA 23 Shtator18:15

[Mesazhi tronditës i 23-vjeçares: Mbani mend emrin tim, mund të mos jem në gjendje të flas më kurrë!](#)

Një thirrje e dëshpëruar për ndihmë, e bërë përmes një mesazhi audio nga qelia e saj e burgut nga një studente...

BOTA 23 Shtator18:08

[VIDEO nga momenti kur avioni ushtarak shpërthen në flakë](#)

Dy pilotë të Forcave Ajrore Mbretërore (RAF) u nxorën nga avioni i tyre i stërvitjes përpara se ai të rrëzohej pranë...

BOTA 23 Shtator17:58

[Kush janë oligarkët rusë që pritet të hiqen nga lista e sanksioneve të BE-së dhe pse janë kaq të rëndësishëm?](#)

Alisher Usmanov dhe Mikhail Fridman, dy prej biznesmenëve më të pasur dhe më të njohur rusë, pritet të hiqen nga lista e sank...

BOTA 23 Shtator17:41

[Komisioni European: Negociatat me Shqipërinë për në BE drejt mbylljes në dhjetor 2027](#)

Komisioni pritet të mbështesë zyrtarisht afatin e anëtarësimit të Shqipërisë në vitin 2027 në një plan t&...

BOTA 23 Shtator17:30

[Jeta si bashkëshortja e Presidentit të SHBA-së, rrëfhet Melania Trump: Punon pa pushim](#)

Zonja e Parë e SHBA-së, Melania Trump, ka folur për marrëdhënien me bashkëshortin e saj, presidentin Donald Trump, duke e për...

BOTA 23 Shtator17:17

[Goditet grupi mafioz në Itali, arrestohen 34 persona, sekuestron miliona të fshehura brenda mureve të shtëpive](#)

Policia italiane arrestoi 34 persona ditën e hënë, 21 shtator 2026, në një operacion të madh që synonte rrjetet e dyshuara t&...

BOTA 23 Shtator17:03

[Tronditëse në Francë, 25-vjeçarja braziliane gjendet e pajetë në bagazhin e një makine](#)

Franca është tronditur nga një ngjarje e rëndë e zbuluar të hënën, më 21 shtator, në Nice, ku 25-vjeçar...

BOTA 23 Shtator15:41

[Qeveria britanike rishikon marrëveshjen për Ishujt Chagos pas kritikave të ashpra nga Trump](#)

Marrëveshja e vonuar prej kohësh mbi të ardhmen e Ishujve Chagos po rishikohet nga qeveria britanike pasi Donald Trump e kritikoi atë si &...

BOTA 23 Shtator15:32

[Rusia provokon sërish, helikopteri ushtarak rus shkel hapësirën ajrore të Polonisë](#)

Një helikopter ushtarak rus Mi-8 bëri një inkursion të shkurtër në hapësirën ajrore të Polonisë, anëtar...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

[Skandal/ Kreu i SHISH mesazh Agasit: Zemër, duh...](#)

Më 18 shtator, Vlora Hyseni është marrë në pyetje nga agjentët e Byrosë Kombëtare të Hetimit si person në di...

POLITIKE 22 Shtator

["Balluku kur do arrestohet?" - Gazetari Qyno: K...](#)

Gazetari Elton Qyno ka debatuar mbrëmjen e sotme me juristët në emisionin "Top Story", lidhur me hetimet e SPAK ndaj ish-zëvend&...

AKTUALITET 22 Shtator

["Pinte kafe çdo javë me Dumanin"/ Urdhër-arrest...](#)


Gazetari Elton Qyno ka komentuar mbrëmjen e sotme në 'Top Story' urdhër-arrestin e SPAK për kreun e SHISH, Vlora Hyseni. Qyno k...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja "mbysin" Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro](#)

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1





“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.